

BIZNESI SHQIPTAR ALBANIAN BUSINESS

QËNDRA PËR KËRKIM DHE ZHVILLIM TIRANË
CENTRE FOR RESEARCH AND DEVELOPMENT

Rr. "Luigj Gurakuqi",
P. 15/1, Shk. 1, Ap. 1
PO. Box 218/1 Tirana

Tel & Fax (0)4 230 445
Mobile: (0)69 22 40 906
E-mail: info@qkzh.org

Rezultatet e vrojtimit të
biznesit dhe konsumatorëve
Nr. 12, dhjetor 2004

www.qkzh.org

Business and Consumer
Survey Results
No 12, December 2004


Në këtë numër:
Zhvillimet ne sektorin e industrise
perpunuese



In this number:
Development in manufacturing sector

KLIMA E BIZNESIT-INDUSTRI/ BUSINESS CLIMATE- INDUSTRY

FIGURA 1: Treguesi i besueshmerise ne industrine perpunuese - totali
CRD Confidence indicator in manufacture - total



Burimi: QKZH, Tirane, Rezultate te anketimit te biznesit

Klima e biznesit ne industri: ne renie por mbetet pozitive

Business climate in manufacturing sector: is weakening but remains positive

Rezultatet e anketimit te muajit tetor tregojnë se **besueshmeria** e biznesmeneve ne sektorin e industrise perpunuese eshte dobësuar per te dyten

here radhazi, por ajo vazhdon te mbetet ne vlera pozitive, duke qendruar akoma mbi vleren me te ulet per te gjithe periudhat e anketimit. Kështu, **treguesi i besueshmerise**¹ në muajin tetor 2004 shënon vlerën pozitive prej 7 pikësh, që është 3 pikë në përqindje më i ulët se një vit më parë, dhe 6 pikë më i ulët se mesatarja e treguesit të konfidencës për periudhën janar 2002-tetor 2004.

¹ Treguesi i besueshmerise ne industri llogaritet si mesatare arithmetike e nivelit te kontraktimeve, parashikimit te prodhimit dhe nivelit te gjendjes se produkteve te gatshme (kjo e fundit me shenjë të kundërt)


Rënia e treguesit të besueshmërisë është influencuar kryesisht nga niveli i ulët i kontraktimeve. **Treguesi i kontraktimeve** në muajin tetor shënon vlerën negative prej 22 pikësh, nivel i cili është më i ulët i rregjistruar gjatë gjithë periudhës së anketimit. Ky nivel është 15 pikë në përqindje më i ulët se 3 muaj më parë, 14 pikë në përqindje më i ulët nga mesatarja dy vjeçare (janar 02-tetor04) dhe 11 pikë më pak se një vit më parë (figura 2).

Megjithatë, nga vlerësimet e kryera duket se menaxheret në tërësi vazhdojnë të jenë optimistë për një rritje të biznesit në 3 muajt e ardhshëm. Kjo reflektohet në **treguesin e balancës për parashikimin e punësimit** në 3 muajt e ardhshëm, që shënon një rritje prej 10 pikësh në përqindje në krahasim me parashikimin e dhene në 3 muajorin e kaluar (shiko figurën 3). Megjithatë ky nivel është 11 pikë në përqindje më i ulët se një vit më parë dhe 2 pikë në përqindje më poshtë se mesatarja e viteve 2002-2004.

Një nga treguesit me rënie më të theksuar gjatë muajit tetor rregjistrohet ai i **kontraktimeve për eksport**, i cili ka një rënie prej 40 pikësh në krahasim me 3 muaj më parë, duke eliminuar në këtë mënyrë edhe optimizmin e verejtur për këtë tregues 3 muaj më parë, i cili shënonte një balancë pozitive prej 10 pikësh (shiko figuren 4). Rënia e nivelit të kontraktimeve për eksport mund të ketë ardhur jo vetëm nga rënia e kërkesave për mallra eksporti, por një ndikim mund të ketë dhënë edhe forcimi i lekut, i cili ka bërë që të dekurajojë eksportuesit për të rritur kuotat e eksporteve.


Treguesi i ecurisë së prodhimit në 3 muajt e kaluar tregon vlerën pozitive prej 5 pikësh, i cili është 5 pikë më i ulët se 3 muaj më parë. Figura 5 tregon, gjithashtu, se nivelet e balancave për vitin 2004 janë shumë më të ulta nga mesatarja e viteve 2002-2004.

FIGURA 2: Vlerësimi i nivelit të kontraktimeve në industrinë perpunuese - totali
Assesment of order-books in manufacturing - total




Burimi: QKZH, Tirane, Rezultate te anketimit te biznesit

FIGURA 3: Parashikimi i punësimit në industrinë perpunuese 2002-2004
Employment expectations in manufacturing sector - total: 2002-2004




Burimi: QKZH, Tirane, Rezultate te anketimit te biznesit

FIGURA 4: Vlerësimi i kontratave për eksport në sektorin e industrisë perpunuese - totali
Assesment of export order-books in manufacture - total



Burimi: QKZH, Tirane, Rezultate te anketimit te biznesit


FIGURA 5: Vlerësimi i aktivitetit të prodhimit në industrinë perpunuese në 3 muajt e kaluar - totali
Assesment of production activity in manufacture the last 3 months - total



Burimi: QKZH, Tirane, Rezultate te anketimit te biznesit

FIGURA 6: Shfrytëzimi i kapaciteteve prodhuese ne industrine perpunuese - totali


Capacity utilisation in manufacture - total



Burimi: QKZH, Tirane, Rezultate te anketimit te biznesit

FIGURA 7: Parashikimi i aktivitetit te biznesit ne industrine perpunuese - totali 2002 - 2004


Expectation of business activity in manufacture - total, 2002 - 2004



Burimi: QKZH, Tirane, Rezultate te anketimit te biznesit

FIGURA 8: Vleresimi per çmimet e shitjes, industria perpunuese - totali


Assessment of selling prices in manufacture - total



Burimi: QKZH, Tirane, Rezultate te anketimit te biznesit

FIGURA 9: Vleresimi i produkteve te gatshme ne industrine perpunuese - total

Assesment of stocks in manufacture - total



Burimi: QKZH, Tirane, Rezultate te anketimit te biznesit

Ecuria e aktivitetit te prodhimit ne industri ne periudhen e fundit eshte gjykuar me pak dinamike se ne korrik gje qe mund te shpjegoje edhe shkallen me te ulet te shfrytëzimit te kapaciteteve prodhuese. **Shfrytëzimi i kapaciteteve prodhuese** ne tetor 2004 shënon vleren 51,3% (figura 6), çka tregon se mesatarisht në 3-mujorin e kaluar sektori i industrisë përpunuese mund të kete shfrytëzuar rreth 6% më pak kapacite prodhuese në krahasim me 3 mujorin e dytë të vitit 2004.

Parashikimi per aktivitetin prodhues ne sektorin e industrise ne tetor (23 pike) mbetet thujse ne te njejtat nivele si dhe ne korrik (24 pike). Megjithate nga figura 7 shikohet se, kjo vlere eshte nen mesataren e llogaritur per periudhen janar 2002 - tetor 2004

Vleresimi per çmimet e shitjes tregon nje permiresim ndoshta te situates financiare per ndermarrjet prodhuese. Balanca e pergjigjeve pozitive me ato negative mbi vleresimin e çmimeve ne tetor (figura 8), tregon nivelin me te larte per gjithë vitin 2004. Edhe e krahasuar me vleresimin e dhene nje vit me pare (tetor 2003) kjo vlere eshte 8 pike ne perqindje me e larte.

Sikurse vihet re nga figura 9, rezultate e anketimit te biznesit ne muajin tetor 2004, vazhdojne te japin vlere negative prej 21 pikesh per **vleresimin e produktit te gatshem**, vlere kjo shume afer nivelit te nje tremujori me pare. Ndoshta firmat prodhuese vazhdojne te ndihen te pasigurta per mundesine e shitjes se produkteve te tyre te gatshme. Vlere e llogaritur ne tetor 2004 eshte 7 pike ne perqindje me e ulet se ajo e vleres mesatare 2002 - 2004.

Pengesat ne sektorin e industrise perpunuese *Constraints within manufacturing sector*

Në bazë të pyetsorit të përgatitur monitorohen rreth 15 faktorë që mund të ndikojnë në ecurinë e prodhimit. Ndër këta më i theksuari nga të intervistuarit ka qenë **mungesa e energjisë elektrike**. Por nga të dhënat e anketes për muajin tetor kjo pengesë është theksuar nga rreth 13% më pak të intervistuar se 3 muaj më parë, ose 56%. Nga figura 10 vihet se ky faktor ka një ndikim sezonal, megjithatë krahasuar me një vit më parë ky faktor është persëri 3% më i ulët, çka tregon për një përmirësim të furnizimit të energjisë elektrike për bizneset e sektorit të industrisë përpunuese.


Rezultatet e vrojtimit në muajin tetor 2004 (figura 11), treguan se pengesa më e rëndësishme për biznesin në sektorin e industrisë përpunuese bëhet **zbatimi i legjislacionit fiskal**, i cili përmendet nga 61% e të anketuarve. Ky faktor shënon një rritje prej 10 pikësh në krahasim me 3 muaj më parë dhe niveli aktual është 26 pikë nga mesatarja e viteve 2002-2003.

Ndikimi i **mungesës së infrastrukturës** gjithashtu tregon një rritje si faktor pengues, pasi në muajin tetor ai përmendet nga 45% e të intervistuarve, nga 36% që përmendej 3 muaj më parë.

Faktorë pengues me ndikim në rritje janë shënuar edhe faktore të tjera si **mungesa e kërkesës nga jashtë, mungesa e paisjeve të përshtshme dhe mungesa e fuqisë punëtore të kualifikuar**.

FIGURA 10 : Ndikimi i mungesave të energjisë elektrike në sektorin e industrisë - totali


The impact of shortages on electricity in manufacture - total



Burimi: QKZH, Tiranë, Rezultate të anketimit të biznesit

FIGURA 11 : Ndikimi i legjislacionit fiskal në sektorin e industrisë - totali


The impact of fiscal legislation in manufacture - total



Burimi: QKZH, Tiranë, Rezultate të anketimit të biznesit

FIGURA 12 : Ndikimi i mungesës së infrastrukturës në sektorin e industrisë - totali

The impact of lack of infrastructure in manufacture - total



Burimi: QKZH, Tiranë, Rezultate të anketimit të biznesit